

VENDIM
Nr. 305, datë 29.4.2026

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 235, DATË 23.3.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KALIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË SARANDË TË SIPËRFAQES 9200 M², NGA TRUALLI FUNKSIONAL I PRONËS NR. 206, “REZIDENCA QEVERTITARE SARANDË”, PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 1058, DATË 16.7.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI KËSHILLIT TË MINISTRAVE, PËR DREJTORINË E SHËRBIMEVE QEVERTITARE”, TË NDRYSHUAR, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 20, DATË 9.1.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË SARANDË TË QARKUT TË VLORËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 7, 8 e 12, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 235, datë 23.3.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në pronësi të Bashkisë Sarandë të sipërfaqes 9200 m², nga trualli funksional i pronës nr. 206, “Rezidenca qeveritare Sarandë”, për një ndryshim në vendimin nr. 1058, datë 16.7.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Këshillit të Ministrave, për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare”, të ndryshuar, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 20, datë 9.1.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Sarandë të Qarkut të Vlorës”, bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Në pikën 1, pas fjalëve “... për ta përdorur për ndërtimin e një shkolle 9-vjeçare” shtohen “... dhe zhvillimin e programeve parauniversitare.”;

b) Në pikën 4, fjalët “... ta tjetërsojë ose ta japë në përdorim për të tretët ...” hiqen.

2. Ngarkohen Bashkia Sarandë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçiu